

LIGJ
Nr. 17/2021

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7864, DATË 29.9.1994, “PËR KRYQIN E KUQ SHQIPTAR”

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7864, datë 29.9.1994, “Për Kryqin e Kuq Shqiptar” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

1. Kryqi i Kuq Shqiptar është një shoqatë humanitare vullnetare, e krijuar më 4 tetor 1921, e njohur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) në vitin 1923 dhe e pranuar po këtë vit në Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe (FNKK).

2. Kryqi i Kuq Shqiptar e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të pavarur në bazë të Parimeve Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, që janë: humanizmi, neutraliteti, paanësia, pavarësia, vullnetarizmi, uniteti, universaliteti, si dhe në respektim të Konventës së Gjenevës të datës 12 gusht 1949, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 maj 1957, të Protokolleve shtesë të Konventës së Gjenevës të datës 10 qershor 1977, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 16 qershor 1993.

3. Kryqi i Kuq Shqiptar është ndihmës i organeve shtetërore në nivel qendror dhe lokal për çështjet humanitare në mbarë vendin.

4. Në respekt të Konventave të Gjenevës, të protokolleve të tyre shtesë dhe të parimit themelor të Unitetit, nuk mund të krijohen dhe të njihen në Republikën e Shqipërisë shoqata ose fondacione të tjera që përdorin emrin dhe emblemën e ndonjërit prej komponentëve të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe (Kryqi i Kuq/Gjysmëhënë e Kuqe/Kristal i Kuq), përveç Kryqit të Kuq Shqiptar.”.

Neni 2

Neni 2 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 3 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

1. Kryqi i Kuq Shqiptar e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të statutit që miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e tij.

2. Çdo ndryshim në statutin e Kryqit të Kuq Shqiptar dërgohet për mendim pranë Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Kryqit të Kuq Shqiptar vetëm pasi të jenë marrë në konsideratë sugjerimet e tyre.”.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si vijon:

“Neni 8

Kryqi i Kuq Shqiptar pranon kontribute të pakufizuara në çdo formë nga ligje të veçanta, nga individë dhe/ose persona fizikë e juridikë shqiptarë ose të huaj dhe organizon mbledhjen e tyre brenda vendit.”.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.2.2021.

Shpallur me dekretin nr. 11980, datë 25.2.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.